




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government
ËKomuna e Drenasit
Drejtoria për Administratë të Përgjithshme
Zyra e Prokurimit
611-21-289-1-3-6/C388



K O N T R A T Ë / F U R N I Z I M

Emri i Projektit: **Makina mjelëse për dy krerë (8 thitha) 2021**

Numri identifikues: 611-20-289-136 , Datë:30.04.2021 ; Nr. i arkivit; 400-17897

PALET NË MARRËVESHJE

KOMUNA E DRENASIT - Drenas, përfaqësuar nga **MENSUR GLLAREVA** Zyrtar i Prokurimit (më tutje "Punëdhënës").

N.T. " Rimida ", P.N., LLAPNASELLË përfaqësuar nga **RRUSTEM HASANI** , Drejtor (më tutje kontraktuese).

Neni 1 Ligji i zbatueshem

Neni 1 Ligji i aplikueshëm

1.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë Ligji Nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 2 Lënda

Lënda e kontratës duhet të jetë : **Makina mjelëse për dy krerë (8 thitha) 2021**

Kontraktuesi duhet të jetë në pajtueshmëri të plotë me afatet e Kushteve të kontratës dhe të aneksit teknik, duke përfshirë të gjitha ndryshimet në variantin e propozuar.

2.1 Vendi i pranimit të **furnizimeve** do të jetë: Komuna e Drenasit, Inkotermi i zbatueshëm do të jetë DDP¹.
Periudha e kryjes së punëve/shërbimeve dhe **furnizimeve** do të jetë deri në afatin : **20 dite**.

Neni 3 Çmimi

Çmimi i furnizimeve është në shumën prej: **6 360,00 €; Gjashtëmijë e treqind e gjashtedhjetë euro, e zero cent)**

3.1 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas bersës përkatëse)

3.2 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e kontratës

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Pagesa do të kryhet çdo herë kur raporton menaxherit te projektit, duke mos e tejkaluar shumën prej: **6 360,00**

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e

pranueshme nese nuk protestohen nje ose me shume nga kerkesat thebesore.

4.3 Kryetari i komunës, Autorizohet në bazë të Nenit 81 të Ligjit Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 të caktoj me një vendim, Menaxherin e Projektit zyrtarin me përvojë në profesion dhe mundësisht nga Krytari i Komunes.

4.4 Komisionin për pranimit të caktoj në Njësit të kërkuar. Afati i kryerjes së **furnizimeve** duhet të jetë brenda **20 dite**. Pranimit duhet të kryhet konform neneve të kontratës dhe duhet të jetë konform Pjesës IV, Nenit 81, pika 1, 2 dhe 3 të Ligjit mbi Prokurim Publik Nr. 04/L-042 dhe dokumentacionit dytësor. Monitorimin e kësaj kontrate dhe pjesët e Planit të Menaxhimit e kryen Drejtoria e Bujqësisë.

- a) Të gjitha pagesat kryhen në euro, pasi të dorëzohen dokumentet më të domosdoshme për pagesë tek Zyrtari për pagesë dhe arkivim. Përqindja % e pagesës, të **furnizimeve** të kryera do të caktohet nga menaxheri Poashtu zyrtari për pagesë para se të kryhet pagesa duhet të bindet se fatura është konform kërkesës dhe çmimorës që është pjesë e kontratës. Çdo faturë duhet të pranohet nga Menaxheri i Projektit.
- b) Të gjitha dokumentet si: aktvendimet, procesverbalet, raportet për **furnizimeve** të kryera, faturat, shkresat, etj. duhet të dorëzohen tek Zyrtari për pagesë.
- c) Zyrtari për pagesë dhe arkivim të lëndëve, obligohet që të gjitha dokumentet rreth pagesave duke përfshirë edhe raportet e pranimit, urdhërit për pagesë dhe urdhërblerjes, t'i arkivoj dhe ruaj. Poashtu obligohet që dokumentet e kërkuara nga auditorët për auditim ose nga palët shtetërore të interesuara t'ju ofroj sa herë që ata kanë nevojë.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i **furnizimeve**/shërbimeve/punëve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit, dhe në pajtim me Menaxherin e caktuar nga Krytari i Komunes.

Neni 7 Garancioni i furnizimeve

7.1 Garancioni për eliminim të metave të furnizimeve do të jetë një vit.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin [t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat] [të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet] [te kryej ndonjë ose të gjitha punët] brenda limiteve kohore të specifikuar në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së **[furnizimeve]** të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi dhe caktimi i menaxherit

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

12.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi të jape Operatorin Ekonomik **shtatë ditë** paralajmërim, ta ndërprese kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e res-judikata; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e res judicata për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumë që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.





13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në një pajtim me ligjin e Kosovës, **Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.**

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.


E hartuar në gjuhën **Shqipe** në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një original për Operatorin Ekonomik.

Pjesë e ofertës është paramasa dhe parallogaria e ofertuesit. Kontrata hynë në fuqi me **19.02.2021**.

Për Autoritetin Kontraktues		Për Kontraktuesin	
Emri:	MENSUR GLLAREVA	Emri:	RRUSTEM HASANI
Pozita:	ZPP	Pozita:	DREJTOR
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	30.04.2021	Data:	30.04.2021
Vula:		Vula:	

SPECIFIKIMI I ÇMIMËVE

NR	PËRSHKRIMI	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI PËR NJËSI €	TOTALI €
1	MAKINA MJELËSE PËR DY KRERË (8 thitha) FINANCIMI I KOMUNES 70%	copë	40	111.30 €	4452 €
2	PARTICIPIMI I FERMEREVE 30%	copë	40	47.70 €	1908 €
	Gjithësej:	copë	40	159 €	6360 €



Hartues i projektit
Dardan Zeneli
